


Zinxhiri i diturisë në sqarimin e çështjeve të metodologjisë (Menhexhit) – Pjesa 2

Aslu Dini (Baza e Fesë)

Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botrave, përfundimi i mirë është për të devotshmit, dhe ska armiqësi vetëm se për të padrejtët. Dëshmoj se nuk ka Zot i cili meriton të adhurohet pos All-llahut, i Vetmi i Pa shok, Sunduesi i Vërtetë dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, udhëheqësi i të parëve dhe të fundëmve.

Në këtë ligjëratë do të flasim për bazën e fesë (Aslu Dinin)

Kjo çështje është çështja kryesore, për shkak se besimi i njeriut nuk është i saktë nëse nuk vjen me këtë çështje.

Çfarë është Aslu Dini (Baza e fesë)?

Aslu Dini është pohimi dhe besimi i All-llahut, pohimi se vetëm All-llahu meriton të adhurohet dhe braktisja e adhurimit të dikujt tjetër pos Tij, dhe distancimi prej atyre që i bëjnë shirk All-llahut të Lartëmadhëruar.

Katër çështje...

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Ibrahimi dhe Musa erdhën me Aslu Dinin, i cili është pohimi dhe besimi i All-llahut, adhurimin e Tij të Vetëm, i pa shok, dhe armiqësimi i atyre që mohuan (bënë kufër) All-llahun." [1] Mbaroi fjala e tij, All-llahu e mëshiroftë.

“Distancimi nga ata që i bënë shirk të Lartëmadhëruarit”: është shprehja e Shejhul Islam ibn Tejmijes, këtu ku thotë: "Armiqësimi i atyre që bënë kufër All-llahun", që të dyja shprehjet e kanë një kuptim, armiqësimi i mushrikëve dhe distancimi i tyre.

Dhe ka thënë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Aslu Dini është që të jetë dashuria për All-llahun, urrejtja për hir të All-llahut, miqësimi për hir të All-llahut, armiqësimi për hir të All-llahut dhe adhurimi për All-llahun." [2] Mbaroi fjala e tij, All-llahu e mëshiroftë.

Dhe duke u bazuar në atë që e përmendëm, themi: Në qoftë se një person vjen (realizon) me tri çështjet nga Aslu Dini dhe nuk e realizon të katërtën, si braktisja e adhurimit të dikujt tjetër pos All-llahut apo lë anash distancimin nga mushrikët, a pranohet besimi i tij?

Përgjigja: Jo!

---

1 Mexhmu’l Fetava, v. 16, f. 203.
2 Minhaxhu Suneh en-Nebevijeh, v. 5, f. 255.

E si emërtohet ky person? Emërtohet mushrik, kafir.
Pra, në këtë përcaktim që është Aslu Dini, nuk arsyetohet askush që është futur në moshën madhore nëse nuk e realizon atë edhe nëse është injorant, pa marrë parasysh i ka arritur mesazhi pejgamberik apo jo, apo thënë ndryshe, i ka ardhur i dërguari apo nuk i ka ardhur.

Thotë Imami i mufesirëve, Ibn Xherir Et-Tabari, All-llahu e mëshiroftë, pasi që përmendi diçka rreth Aslu Dinit, tha: "Nuk arsyetohet me injorancë në këtë askush që është i moshës madhore, i ka ardhur atij nga ana e All-llahut i dërguar apo nuk i ka ardhur i dërguari, ka takuar njerëz tjerë pos vetes apo nuk ka dikë pos vetes së vet." [3] Mbaroi fjala e tij, All-llahu e mëshiroftë.
Nuk ka parë asnjë njeri përveç vetes së tij, pra nuk e ka parë asnjë njeri sikur ai që jeton në ndonjë ishull të largët dhe nuk ka mundësi ta shohë ndonjë njeri pos vetes së tij.

Themi: Nëse i arrinë i dërguari (Pejgamberi) po ashtu në Aslu Din përfshihet edhe besimi i Pejgamberit dhe asaj me të cilën ka ardhur ai në mënyrë të përgjithshme.

Pra, besimi i Muhamedit ﷺ, dhe mesazhit të tij në mënyrë të përgjithshme, që nga fillimi i pejgamberisë deri më sot përfshihet në Aslu Din, ngase Aslu Dini është: dy dëshmitë.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: “Aslu Dini është: “Dëshmia: (لا إله إلا الله) Nuk ka Zot i cili meriton të adhurohet pos All-llahut dhe dëshmia: (محمد رسول الله) Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij” [4]

3 Et-Tebsir Fi Mealimi ed-Din, f. 126.
4 Mexhmu’l Fetava, v. 1, f. 10.

Mirë, (tani që e dimë këtë) çfarë do të thotë "besimi në All-llahun"?

Do të thotë: Besimi për ekzistencën e Tij ﷻ, se Ai është i cilësuar me cilësi të përsosura, është i Pastër nga çdo e metë, dhe se të Lartmadhërishmit i takon krijimi dhe sundimi. Thotë All-llahu ﷻ (kuptimi): **"…Atij i takon krijimi dhe sundimi (Pushteti)…"** [5]

Ka prej pushtetit kozmologjik, ku i Lartmadhërishmi i thotë diçkaje bëhu dhe ajo bëhet, dhe ka prej pushtetit sheriatik, e kjo realizohet duke e njësuar të Lartmadhëruarin në çështjen e hallallit dhe haramit.

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: "Prej Aslu Dinit është se nuk ka haram pos asaj që e ka ndaluar All-llahu, dhe nuk ka fe pos asaj që e ka legjitimuar All-llahu. All-llahu i Lartmadhëruar në suren En-A'am dhe El-Araf i ka qortuar mushrikët se ata i ndalonin sendet që All-llahu nuk i ka ndaluar dhe legjitimuan prej fesë atë që nuk e lejoi All-llahu." [6]

Edhe njëherë çfarë është Aslu Dini? Besimi në All-llahun, Njësimi i Tij në adhurim, braktisja e adhurimit të dikujt tjetër pos Tij dhe distancimi nga mushrikët.

Mirë, çfarë do të thotë "njësimi i Tij në adhurim dhe braktisja e adhurimit të dikujt tjetër pos Tij dhe distancimi nga mushrikët"?

Do të thotë: Vetëm Atë ta adhurojmë, ta duam dhe rregullojmë teuhidin, t'i duam Muvehidët (besimtarët), ta konsiderojmë të shëmtuar shirkun, të largohemi prej tij dhe t'i armiqsojmë vepruesit e shirkut.

5 Surja El-Araf, Ajeti 54.
6 Mexhmu'l Fetava, v. 20, f. 357.

Thotë Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë: “Në qoftë se mirësia e teuhidit dhe shëmtimi i shirkut nuk janë të njohura me logjik (të shëndoshë) dhe të vendosura në natyrshmërin (e njerëzve), atëherë logjika nuk ka siguri dhe bindje për asnjë çështje. Me të vërtetë kjo çështje është prej çështjeve të padiskutueshme dhe më të qarta që All-llahu i ka vendosur në logjikën e njeriut dhe në natyrshmërin e tyre.” [7]

“...miqësimi i atyre që besuan,” pra kjo është El-Vela (Dashuria), pra miqësimi i besimtarëve. “...armiqësimi i atyre që bënë kufër,” pra kjo është Vel-Bara (Urrejtja) distancimi nga mushrikët.
Nga kjo e kuptojmë që dashuria dhe urrejta (për hir të All-llahut) përfshihen në Aslu Dinin Islam.

Këtu kemi një çështje të rëndësishme.

Dallimi mes ekzistimit të armiqësis së jobesimtarëve dhe shfaqjes së saj, e para, ‘ekzistimi i armiqësis’ është prej Aslu Dinit, kurse e dyta ‘shfaqja e armiqësis’ është prej vaxhibateve (obligimeve) e nuk është prej Aslu Dinit.

Thotë Shejh Abdu-Latif ibn Abdurrahman Ali Shejh, All-llahu e mëshiroftë: “Shfaqja e armiqësis nuk është e njëjtë me ekzistimin e armiqësis, tek e para (shfaqja) arsyetohet në rast dobësie apo frike, thotë All-llahu (kuptimi): **“Për tu ruajtur prej të keqës së tyre…”** [8]**,** kurse e dyta (ekzistimi i armiqësis) është i patjetërsueshëm për shkak të përfshirjes së tij në mohimin e tagutit, ka një lidhje direkte mes kësaj dhe dashuris për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, që besimtari nuk mund të largohet nga kjo.” [9]

7 Medarixhu Salikin, v. 3, f. 455.
8 Surja Ali Imran, Ajeti 28.
9 Ed-Duraru Senije, v. 8, f. 359.

Siç e përmendëm se në Aslu Din nuk arsyetohet askush me injorancë kush e prish atë i tilli nuk është Musliman dhe etiketimi i kufrit nuk ngrihet nga ai.

Pse nuk arsyetohen me injorancë burri apo gruaja në Aslu Din?

Sepse kjo çështje njihet nëpërmjet premtimit (natyrshmërisë dhe logjikës së shëndoshë).

Thotë Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë: “Aslu dini është adhurimi i All-llahut, esenca e së cilës është dashuria dhe kthimi te All-llahu (me pendim dhe nënshtrim), dhe të i'a kthesh shpinën çdo gjëje tjetër pos All-llahut, e kjo është natyrshmëria që All-llahu i krijoi njerëzit.” [10]

Thotë Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë: “E çka mund të ketë të saktë në mendje nëse në të nuk ka dituri për shëmtueshmërin e shirkut. Dituria për shëmtueshmërin e shirkut është çështje e padiskutueshme dhe domosdoshmërisht njihet me mendje të shëndoshë.” [11]

Nga këtu kuptojmë se, nuk është kusht ngritja e argumentit për gjykimin në kufër mbi atë që nuk e ka realizuar atë (Aslu Dinin), pra e gjykojmë në kufër atë i cili nuk e ka realizuar Aslu Dinin pa marrë parasyshë është ngritur ose jo argumenti në atë person.

Deklarojmë edhe njëherë, se në këto çështje nuk arsyetohet askush me injorancë, pra në Aslu Din, për shkak se kjo dituri është e domosdoshme dhe e vendosur në natyrshmërin dhe mendjen e njeriut. Kush e prish

10 Mexhmu’l Fetava
11 Medarixhu Salikin, v. 1, f. 253.

Aslu Dinin ai është mushrik, mirëpo dënimi i tij në këtë botë dhe botën tjetër është i kushtëzuar në ngritjen e argumentit pejgamberik (nuk dënohen para ngritjes së argumentit).

Thotë Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë: “E kufri për shkak të injorancës të cilëve nuk i’u është ngritur argumenti dhe nuk kanë pasur mundësi të njësojnë Atë, këta njerëz nuk i dënon All-llahu para ngritjes së argumentit të pejgamberëve.” [12]

Pyetje: Çfarë e prish Aslu Dinin?

Përgjigje: Shirku!

Më herët përmendëm definicionin e Aslu Dinit se është: Besimi në All-llahun, adhurimi i Tij i vetëm, largimi nga zotat tjerë pos All-llahut, dhe distancimi nga ata që i bëjnë shirk të Lartmadhëruarit.

Pra shirku e prish Aslu Dinin dhe e asgjëson atë. Kuptimi i shirkut sheriatikisht: T’i bësh ortak All-llahut në Rububije, Uluhije dhe Esma ve Sifat (Emrat dhe Cilësit e Tij).

Shembulli i shirkut në Rububije: T’i bësh ortak All-llahut në atë se ka krijues, furnizues, mbikqyrës, sundues, dhe ligjvënës tjetër pos All-llahut.

Shembulli i shirkut në Uluhije: Sexhdeja, lutja, betimi, therja e kurbanit, për dikë pos All-llahut.

Dhe shembulli i shirkut në Emrat dhe Cilësit e Tij: Mohimi i tyre si,

12 Tarikul el-Hixhretejn, f. 414.

mohimi i diturisë, dëgjimit, shikimit të All-llahut apo ngjasimi me krijesat.

E gjithë kjo që përmendëm është shirk, nuk arsyetohet me injorancë në këto çështje askush prej mushrikëve për shkak se në këtë e ka prishur Aslu Dinin. All-llahu i Lartmadhëruar në Kur'an i ka gjykuar në kufër ata që pasojnë qorrazi (në shirk) po ashtu i ka gjykuar në kufër analfabetët e pasuesve të librit për shkak injorancës dhe i ka gjykuar me kufër injorantët prej mushrikëve Arabë para pejgamberis së Pejgamberit ﷺ.

Thotë Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë: "Kush vdes mushrik i tilli është në zjarr, edhe nëse ka vdekur para ardhjes së pejgamberit, për shkak se mushrikët e ndryshuan fenë e pastër të Ibrahimit, paqja e All-llahut qoftë mbi të, dhe e zëvendësuan atë me shirk dhe vepruan shirkun, ata nuk patën asnjë argument nga ana e All-llahut. Shëmtueshmëria dhe kërcënimi me zjarr në vazhdueshmëri ka qenë e njohur nga feja e pejgamberëve nga i pari deri te i fundit. Lajmet se si All-llahu i ka dënuar kanë qenë të përhapura gjenerat pas gjenerate dhe All-llahut i takon argumenti i përsosur kundër mushrikëve ne çdo kohë, edhe sikur mos të kishte argumente do të mjaftonte natyrshmëria që All-llahu i krijoi robërit e Tij për njohjen e teuhidit Rububije i cili ndër vete ngërthen teuhidin Uluhije dhe është e pamundur që në të gjitha natyrshmërit dhe mendjet të ekzistojë i adhuruar (Zot) tjetër pos Tij, edhe pse All-llahu i Lartësuar nuk e dënon njeriun duke u argumentuar në natyrshmërin (thirrja e të dërguarve vazhdimisht ka qenë e njohur). Mushriku e meriton dënimin për shkak të kundërshtimit të pejgamberëve. All-llahu e di më së miri." [13]

13 El-Huda, v. 3, f. 685.

E sa i përket injorantëve prej mushrikëve pas ardhjes së Pejgamberit ﷺ prej atyre që përkatësohen në Islam dhe të tjerëve, me të vërtetë çështja e tyre është edhe më e rëndë, për shkak se në shumicën e rasteve ata i kaploi injoranca për shkak të kthimit të shpinës (mos interesimit) mesazhit të Pejgamberit ﷺ, kurse vetë mos interesimi për fenë është kufër, e si është puna nëse kësaj i shtohet edhe shirku?

Thotë Sheukani, All-llahu e mëshiroftë: "Kushdo që bën shirk për shkak të injorancës nuk arsyetohet, për shkak se argumenti është ngritur në dërgimin e Muhamedit ﷺ. Kush nuk di, ajo është për shkak të kthimit të shpinës Kur'anit dhe Sunetit për shkak se në ato të dyja ka shpjegim të qartë të mos interesit, po siç thotë All-llahu i Lartmadhëruar (kuptimi): "**...Shpjeguesi për çdo send, udhëzim dhe mëshirë.**" [14] Njejtë edhe Suneti, thotë Ebu Dherri, All-llahu qoftë i kënaqur me të: "Vdiq Muhamedi ﷺ dhe nuk la as edhe një zog që po fluturonte mes tokës dhe qiellit vetëm se na përmendi dituri për të", apo siç tha, All-llahu qoftë i kënaqur me të: Kush nuk di, shkak është mos interesimi i tij, e askush nuk arsyetohet me mos interesim. [15]

Argumentet për mos arsyetim me injorancë në shirk të madh që e prish Aslu Dinin janë shumë.

1. Thotë All-llahu ﷻ (kuptimi): "**Një grup Ai e drejtoi dhe një grup meritoi të jetë me të gabuarën, (sepse) në të vërtetë ata zgjodhën shejtanët për mbrojtës e ndihmës në vend të All-llahut, duke menduar në këtë mënyrë se janë të udhëzuar drejt.**" [16]

14 Surja Nehël, Ajeti 89.
15 El-Feth Er-Rabani v. 1, f. 146.
16 Surja El-Araf, Ajeti 30.

Thotë Imam Tabariu, All-llahu e mëshiroftë: “Thotë All-llahu ﷻ:
Grupi i cili e meritoi të jetë i humbur devijoi nga rruga e All-llahut për shkak se i morën shejtanët për ndihmues dhe përkrahës e këtë e vepruan për shkak se nuk e dinin gabimin në të cilin ishin. Ata e vepruan këtë vepër duke menduar se janë në të drejtë dhe në udhëzim, dhe se vepra e tyre është e saktë. Ky ajet është prej argumenteve më të qarta për gabimin e atyre që mendojnë se ‘All-llahu nuk e dënon dikë që vepron mëkate apo ka besime të kota, vetëm nëse i vepron pas ngritjes së argumentit duke qenë kryelartë ndaj Zotit të tij’, për shkak se nëse çështja do ishte siç thonë ata, atëherë nuk do të kishte ndonjë dallim mes grupit që devijoi duke menduar që është në rrugë të drejtë dhe grupit të udhëzuar kurse All-llahu ka bërë në këto ajete dallimin mes tyre në emra dhe dispozita.” [17]

2. Prej argumenteve të mos arsyetimit me injorancë në shirk është fjala e All-llahut ﷻ (kuptimi): “**Thuaj: A t`iu tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre. Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendonin se janë kah bëjnë mirë.**” [18]

Thotë Imam Tabariu, All-llahu e mëshiroftë: “Edhe ky ajet është prej argumenteve më të fuqishme mbi gabimin e atyre se ‘nuk bën kufër në All-llahun askush pos nëse ka për qëllim kufrin pas ardhjes së argumentit për njëshmërin e All-llahut’, për shkak se All-llahu na informoi për ata që i cilësoi në këtë ajet se mundi që ata e dhanë në këtë botë ishte i kotë edhe pse ata mendonin se janë duke vepruar mirë dhe na informoi se ata ishin që i mohuan argumentet e Zotit të tyre. Sikur të ishte çështja ashtu siç thonë disa se ‘nuk bën kufër në All-llahun askush

17 Tefsiri Tabariut, v. 12, f. 388.
18 Surja El-Kehf, Ajetet 103 - 104.

përveç pas ngritjes së argumentit', atëherë do të duhej që grupi të cilët devijuan duke menduar se janë duke bërë mirë të shpërblehen për punën e tyre, mirëpo çështja është ndryshe nga ajo që thonë ata.
All-llahu i Lartmadhëruar na informoi se ata njerëz (të përmendur në ajet) ishin jobesimtarë dhe veprat e tyre ishin të asgjësuara." [19]

Mirë, kur e gjykojmë dikë me kufër edhe shirk, dhe në çfarë rezulton gjykimi jonë?

Gjykimi jonë për dikë në kufer apo shirk edhe nëse është injorant rezulton në këtë: Ndërprerja e miqësimit mes nesh dhe atij deri sa të pendohet te All-llahu i Lartmadhëruar, mos të kemi martesa (akte nikahu) me të, mos të hahet e therura e tij, mos të kërkojmë falje për të nëse vdes, dhe ai nuk ka hise në të drejtat që i ka obliguar All-llahu për Muslimanët dhe dispozitat e tjera.

E sa i përket dënimit të tij në këtë botë dhe botën tjetër, kjo është e kushtëzuar me ngritjen e argumentit pejgamberik, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, dhe argument për këtë është fjala e All-llahut ﷻ (kuptimi): "**...E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin.…**" [20] dhe fjala e Tij (kuptimi): "**Dhe sikur t'i ndëshkonim ata me ndonjë dënim para tij (para se ta shpallim Kur'anin), ata do të thonin: "Zoti ynë, përse nuk na çove ndonjë të dërguar që t'iu përmbaheshim fakteve Tua para se të poshtëroheshim e të mjeroheshim**" [21]

E theksojmë edhe njëherë se kush nga ky Umet vepron shirkun (e madh) ai është mushrik, kafir, edhe nëse pretendon Islamin dhe shqipton

19 Tefsiri Tabariut, v. 18, f. 128.
20 Surja El-Isra, Ajeti 15.
21 Surja Ta-ha, Ajeti 134.

shehadetin. Thotë All-llahu i Lartmadhëruar (kuptimi): **“Dhe sigurisht që tashmë të është shpallur ty (O Muhamed) si dhe atyre (të Dërguarve) para teje:** “**Në qoftë se bashkoni të tjerë në adhurim me All-llahun, sigurisht që gjithë veprat tuaja do të jenë të pavlera dhe padyshim që do të ishe nga të humburit.**” [22]

Pasiqë All-llahu i përmendi pejgamberët e Tij, paqja e All-llahut qoftë mbi ta, tha (kuptimi): “**Ky është Udhëzimi i All-llahut me të cilin Ai udhëheq këdo që Ai dëshiron nga robët e Tij. Por sikur ata të kishin bashkuar të tjerë në adhurimin e All-llahut, gjithçka që ata kanë punuar do të kishte qenë pa asnjë vlerë për ta.**” [23]

Këto ajete janë prej argumenteve më të fuqishme se shirku e asgjeson Islamin dhe se kush nga ky Umet vepron shirkun (e madh) i tilli është kafir edhe nëse shqipton shehadetin dhe vepron dispozita tjera të Islamit.

E përmbyllim me dy çështje:

1. Cila është dispozita e personit i cili ka realizuar Aslu Dinin, adhuron vetëm All-llahun dhe nuk i bën shirk Atij, dhe beson të Dërguarin e Tij ﷺ, mirëpo nuk e di definicionin e Aslu Dinit?

Pra nëse ti e pyet atë “Çfarë është Aslu Dini?” fillon të përshpëritë dhe nuk e di përgjigjen. Nuk i bën dëm atij nëse e ka realizuar Aslu Dinin, pra mos dija e definicioneve terminologjike në këto çështje nuk i bën dëm (nuk e cënon) në fe.
Argumentet për këtë janë hadithet që ka nxjerrë Buhariu dhe Muslimi, shprehja është e Buhariut.
Nga Muadh Ibn Xhebeli, All-llahu qoftë i kënaqur me të, thotë: *“Isha*

22 Surja Ez-Zumer, Ajeti 65.
23 Surja En-Aam, Ajeti 88.

pas Pejgamberit ﷺ mbi kafshë, dhe tha: "O Muadh, thash: Urdhëro. E përsëriti të njejtën tri herë: A e di se çfarë është e drejta e All-llahut mbi robërit? Thash: Jo. Tha: E drejta All-llahut mbi robërit është se duhet ta adhurojnë atë e mos t'i shoqërojnë diçka në adhurim." [24]

Pra injoranca që Muadhi e kishte për të drejtën e All-llahut mbi robërit nuk e futi në kufër apo shirk, për shkak se ai e kishte realizuar këtë çështje edhe pse nuk e dinte definicionin sheriatik i cili aludon në këtë kuptim.

2. Çështja e dytë: Njëra prej çështjeve që përmenden tek Aslu Dini ka mundësi të jetë e paqartë për disa nga kërkuesit e dituris se ajo është prej Aslu Dinit, e ajo është meseleja e armiqësimit të mushrikëve dhe miqësimi i besimtarëve dhe mendojnë se është prej vaxhibateve (obligimeve) e jo prej Aslu Dinit, apo ndalet në të, kjo nuk konsiderohet anullim i Aslu Dinit përderisa ai e ka realizuar distancimin prej mushrikëve dhe miqësimin për besimtarët.

Thotë Sulejman Ibn Abdilah, All-llahu e mëshiroftë: "Mjafton që Muslimani të dijë se All-llahu i`a ka obliguar armiqësimin e mushrikëve dhe ka ndaluar miqësimin e tyre, dhe e ka obliguar atë që t'i dojë dhe miqësojë besimtarët dhe na ka informuar se kjo çështje është prej kushteve të imanit (besimit) dhe e ka mohuar besimin e atij që i miqëson (mushrikët), "**...E të dojë atë që kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, fëmijët e tyre, vëllezërit apo farefisi i tyre.**" E sa i përket të qënurit të saj në kuptimin e fjalës *'la ilahe il-lAll-llah'* apo prej atyre që kuptohen nga shehadeti, për këtë nuk na ka obliguar All-llahu të studiojmë në të. All-llahu na ka ngarkuar të dimë se është obligim ajo që

24 Buhariu dhe Muslimi.

u përmend më sipër, dhe obligoi të veprohet me të. Kjo pra është obligim i prerë në të cilin nuk ka dyshim. E kush arrin ta kuptojë se është kjo në kuptimin e shehadetit apo është Lazim (që kuptohet prej shehadetit) themi është vepër e mirë dhe të shtyn në mirësi, e kush nuk e di, nuk e ka obligim diturinë këtu, posaçërisht nëse kjo polemik shpie në sherr dhe përçarje mes besimtarëve të cilët i realizuan obligimet e besimit, luftuan për All-llah, i armiqësuan mushrikët dhe miqësuan Muslimanët.” [25]

Do të mjaftoheni në këtë që përmendëm, lusim All-llahun të na bëjë dobi me atë që na ka mësuar, të na bashkojë në të vërtetën, të na bëjë udhëzues e të udhëzuar dhe për fund falënderimi i takon All-llahut Zotit të botrave.

Fundi i pjesës së dytë (2/6)
Përktheu: Ebu Lejth Albani

25 Ed-Duraru es-Senije, v. 8, f. 166.

